FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.128 **3 tetor** **2007**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF nr.21, datë 18.9.2007	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.369, datë 13.6.2007 "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore"...	3607
Udhëzim i MMPAU nr.5, datë 24.9.2007	Për dhënien në përdorim të fondit të gjuetisë për mbarështimin e faunës së egër	3608
Urdhër i MPÇSSHB nr.1712, datë 18.9.2007	Për formën, përmbajtjen e dokumentit dhe procedurën e përfitimit të statusit të emigrantit	3612
Vendim i KQZ nr.1874, datë 28.9.2007	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zonën zgjedhore nr.31, të datës 23.9.2007	3614
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Hamit Adem Sinani	3614

UDHËZIM
Nr.21, datë 18.9.2007

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.369, DATË 13.6.2007 "PËR FONDIN E VEÇANTË NË INSTITUCIONET BUXHETORE"

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.369, datë 13.6.2007 "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore", pika 5, Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Fondi i veçantë në institucionet buxhetore do të krijohet në masën 5% të fondit të planifikuar të pagave. Fondi i planifikuar i pagave, për efekt të llogaritjes së fondit të veçantë, do të përfshijë vetëm fondin e pagave të planifikuar për numrin e miratuar të punonjësve buxhetorë. Në këtë fond nuk përfshihen fondi i pagave që përdoret për punonjësit me kontratë, për punonjësit në listë pritje, për ushtarakët në reformë, punonjësit arsimorë në dispozicion, pagesa e bashkëshortëve të ushtarakëve, studentëve ushtarakë, punonjësve me kontratë të përkohshme etj.

2. Ky fond të përdoret nga drejtuesit e institucioneve për:

- Shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë;
- Shpërblimin e punonjësve në fund të vitit kalendarik;
- Shpërblime të tjera të parashikuara me akte të tjera ligjore apo nënligjore;
- Dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera;
- Veprimtari social-kulturore.

3. Shpërblimi për rezultate të mira në punë gjatë vitit, për çdo punonjës, do të jetë i diferencuar, por nuk duhet të jetë më shumë se 1 (një) pagë mujore për person. Ky shpërblim, në ministritë dhe institucionet qendrore, të cilat janë në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, jepet i diferencuar në bazë të rezultateve individuale në punë, sipas parimeve dhe procedurës së përcaktuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe në përputhje me fondin e shpërblimit në dispozicion. Në institucionet buxhetore, të cilat nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, shpërblimi i punonjësve do të bëhet i diferencuar në bazë të performancës së punonjësit, por jo më shumë se 1 (një) pagë mujore për person. Edhe në rastet kur me ligje të veçanta masa e shpërblimit është më e madhe se një pagë mujore, ajo do të përballohet nga ky fond i veçantë.

4. Shpërblimi në fund të vitit i jepet çdo punonjësi buxhetor, për festat e fundvitit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe përballohet nga fondi i veçantë.

5. Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera përfshihen pagesat për:

- Rastet e vdekjes së punonjësit ose të një anëtari të familjes së punonjësit (prindërit apo fëmijët), kur bashkëjetojnë. Pagesa jepet nga titullari i institucionit i diferencuar nga 10 000-30 000 lekë për çdo rast.
- Rastet e sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje shëndetësore jashtë vendit. Pagesa jepet nga titullari i institucionit, i diferencuar nga 30 000-50 000 lekë për çdo rast.
- Rastet e daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit në masën e një page mujore.

6. Veprimtaritë e ndryshme, që kanë karakter social apo kulturor sikurse janë ato të organizuara për rastet e daljeve në pension, të festimeve të fundvitit, dhe të tjera organizime të realizuara nga institucioni, mund të përballohen nga fondi i veçantë.

Në këto veprimtari social-kulturore, kur ato organizohen jashtë qendrës së punës, shpenzimet e transportit dhe akomodimit paguhen nga vetë punonjësit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.5, datë 24.9.2007

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT TË GJUETISË PËR MBARËSHTIMIN E FAUNËS SË EGËR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.9219, datë 8.4.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë"",

UDHËZOJ:

I. Të përgjithshme

1. Pjesë të fondit kombëtar të gjuetisë në pronësi të shtetit, u jepen në përdorim personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, vetëm kur:

a) në to do të zbatohen projekte apo do të ushtrohen veprimtari, që janë në përputhje me qëllimet e përcaktuara në ligj;

b) projektet e veprimtaritë sjellin përmirësime të dukshme në mbarështimin e faunës që jeton në këto sipërfaqe;

c) projektet e veprimtaritë do të realizojnë investime që përmirësojnë tregues biologjikë dhe të infrastrukturës së zonës;

d) projektet e veprimtaritë janë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me planet e menaxhimit të zonës;

e) projektet e veprimtaritë respektojnë kërkesat dhe elementet e nevojshme për strehim, ushqim, folezim, qetësi etj., të llojeve të faunës së egër që jetojnë në zonë;

f) projektet e veprimtaritë nuk cenojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike të zonës.

II. Kërkesa

1. Personi fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që synon të marrë në përdorim fondin e gjuetisë për veprimtari për mbarështimin e faunës, paraqet kërkesën me shkrim në drejtorinë e shërbimit pyjor të rrethit që administron sipërfaqen e kërkuar.

2. Kërkesa përmban:

a) gjeneralitetet e kërkuesit dhe të subjektit që ai përfaqëson si emri, adresa e saktë, telefoni etj.;

b) një parashtrim të shkurtër të veprimtarisë që do të ushtrojë;

c) investimet që parashikon të bëjë;

d) kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

3. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë:

a) Fotokopje të noterizuar të vendimit të gjykatës që e ka regjistruar si person fizik apo juridik;

b) Vërtetim që është i regjistruar në organin tatimor;

c) Deklarim personal që i ka mjetet e nevojshme monetare, materiale dhe personelin e kualifikuar për të kryer normalisht veprimtarinë;

d) Një përshkrim të veprimtarive e projekteve që ka realizuar më parë, nëse ka;

e) Projekti teknik që hartohet nga specialistë të licencuar, dhe që trajton të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;

f) Planimetria e sipërfaqes së kërkuar në shkallë 1:10000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore si kufijtë natyralë, konfiguracioni, relievi etj., dhe të paraqiten, dhe pozicioni i objekteve të reja në rast se do të ketë;

g) Dokumente që provojnë se organet e qeverisjes vendore dhe komuniteti përreth, janë dakord me zbatimin e projektit në sipërfaqen e kërkuar.

4. Në mënyrë të veçantë projekti teknik minimalisht trajton:

i) Sigurimin e rritjes dhe mbarështimin e një ose më shumë llojeve të faunës së egër;

ii) Garantimin e strehimit natyror, ushqimin në natyrë dhe ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë sipas ligjeve në fuqi;

iii) Kushtet e jetesës në rast të mbajtjes së faunës në gjendje të mbyllur;

iv) Garantimin e bimësisë natyrore të mjaftueshme në sasi për ushqimin e llojeve të faunës kryesore gjatë gjithë vitit, duke pranuar një ushqim plotësues gjatë një periudhe të caktuar të vitit;

v) Përmbushjen e tre kushteve kryesore: të mbrojë gjahun nga dëmtuesit, faktorët klimatikë, si dhe të sigurojë kushte për riprodhim;

vi) Programin për vetëmonitorimin e veprimtarisë gjatë zbatimit të projektit;

vii) Planin për përballimin e emergjencave, aksidenteve dhe fatkeqësive natyrore.

5. Aplikuesi mban përgjegjësi për vërtetësinë e dokumentacionit që ka paraqitur. Në qoftë se edhe një dokument i vetëm rezulton jo i vërtetë, kërkesa nuk shqyrtohet, leja nuk miratohet ose anulohet e hiqet po qe se është dhënë.

III. Shqyrtimi i kërkesës

1. Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP) e rrethit përkatës, merr në dorëzim dhe regjistron dosjen e paraqitur. Në rastet kur dosja nuk është e plotë, ajo ia kthen kërkuesit për plotësim. Koha për plotësimin e dosjes nga kërkuesi nuk llogaritet në afatet procedurale, të cilat fillojnë nga dita e pranimit dhe regjistrimit të dosjes.

2. DSHP-ja e shqyrton dosjen, harton raportin e saj teknik në përputhje me kërkesën dhe zonën ku do të zbatohet projekti dhe shpreh me shkrim mendimin e saj zyrtar për projektin.

3. DSHP-ja e përcjell dosjen për shqyrtim në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të saj.

4. Në ministri dosja shqyrtohet nga një komision i posaçëm, që kryesohet nga drejtori përgjegjës për çështjet e faunës. Në përbërje të komisionit marrin pjesë specialistë të sektorit të faunës, të burimeve pyjore dhe të sektorit të legjislacionit. Mendimi i sugjerohet ministrit, i cili në rast miratimi, aprovon lejen sipas modelit bashkëngjitur.

5. Ministria e shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të dosjes nga DSHP-ja dhe njofton me shkrim subjektin për vendimin e marrë.

6. Tarifa e shqyrtimit dhe miratimit të lejes paguhet paraprakisht dhe është e pakthyeshme.

7. Kundër vendimit, kërkuesi mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

8. Kërkuesi vihet në dijeni për miratimin e lejes. Leja i jepet atij pasi ka shlyer qiranë vjetore të përdorimit për sipërfaqen që i është akorduar. Për vitet pasardhëse kjo tarifë paguhet në fillim të vitit kalendarik dhe jo më vonë se data 30 janar. Nëse nuk paguhet tarifa brenda këtij afati, Policia Pyjore bllokon kryerjen e veprimtarisë për këtë vit.

9. Udhëzimi nr.3, datë 7.6.2006 “Për dhënien në përdorim të fondit të gjuetisë për mbarështimin e faunës së egër”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes së Natyrës
Sektori i Faunës

Rruga "Durrësit" nr.27, Tiranë, Tel.270624 Fax. 270 627

Nr._____Prot. Tiranë, më _____

Vendimi nr. _____

LEJE E INTEGRUAR

PËR
DHËNIE NË PËRDORIM
TË PJESËVE TË FONDIT TË GJUETISË

Në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr.9219, datë 8.4.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë" dhe të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit",

Subjektit ".....", me përfaqësues Z._____, me qendër në _____, i jepet leja,

Për marrje në përdorim të fondit të gjuetisë në rrethin _____,

Për zbatimin e projektit: .....

Vendndodhja:

Sipërfaqja: _____ ha

Sipas kërkesës dhe të dhënave të dosjes i jepet leja e marrjes në përdorim, me kushtin që të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- Të rriten një ose më shumë lloje për mbarështim dhe objekt gjuetie;
- Të garantohet mundësia për strehim natyror, ushqim natyror dhe ushtrim të gjuetisë;
- Të sigurojë vazhdimësinë me bimësi të pasur me lloje të mjaftueshme në sasi për të garantuar ushqimin e llojeve kryesore gjatë gjithë vitit, duke pranuar një ushqim plotësues gjatë një periudhe të caktuar të vitit;
- Të mbrojë gjahun nga dëmtuesit, nga kushtet klimaterike, si dhe të sigurojë kushte për riprodhim;
- Të kryhet monitorimi periodik dhe informacioni të dërgohet në DSHP-në e rrethit çdo vit.
- Të marrë masa për ruajtjen në tërësi të objektit nga veprimet e kundërligjshme që shkaktojnë dëmtim të florës dhe faunës së egër.

Të zbatohet me përpikmëri:

- Ligji nr.7875, datë 23.11.2004 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë", i ndryshuar;

- Ligji nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.449, datë 26.6.2003 "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.236, datë 21.4.2005 "Për disa ndryshime e shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.449, datë 26.6.2003 "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave";

- Rregullorja nr.1, datë 23.2.2005 "Për mbarështimin, mbrojtjen e faunës së egër dhe zhvillimin e gjuetisë".

Kjo leje është e vlefshme për një periudhë _____vjeçare, me të drejtë përtëritjeje.

Mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe njëvjeçare sjell për pasojë pavlefshmërinë e lejes për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Shfaqja e elementeve të reja ekologjike të panjohura, në kohën që kjo leje është dhënë, bën rivlerësimin ose heqjen e lejes.

Për mosrespektimin e kërkesave të legjislacionit përkatës dhe të kushteve të lejes, ka sanksione ligjore.

Mbështetur në udhëzimin nr.1, datë 23.11.2005 "Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore", leja e mësipërme klasifikohet në pikën _____, germa _____.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

URDHËR
Nr.1712, datë 18.9.2007

PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN E DOKUMENTIT DHE PROCEDURËN E PËRFITIMIT TË STATUSIT TË EMIGRANTIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 13, pika 2 të ligjit nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi",

URDHËROJ:

1. Çdo emigrant i regjistruar në "Regjistrin për emigrantët", që plotëson dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri, përfiton "Statusin e emigrantit".

2. "Statusi i emigrantit" është dokumenti zyrtar, sipas formatit bashkëngjitur, i cili identifikon emigrantin, me qëllim gëzimin e përfitimeve të përcaktuara në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".

3. Elemente të përmbajtjes së dokumentit "Statusi i emigrantit" janë:

a) gjeneralitetet e emigrantit;

b) statusi i punësimit të emigrantit në momentin e lëshimit të dokumentit;

c) statusi i pjesëtarit/pjesëtares së familjes së emigrantit;

d) data e lëshimit të dokumentit;

e) afati i vlefshmërisë së dokumentit.

4. Për të përfituar "Statusin e emigrantit", çdo emigrant depoziton në zyrën përkatëse të punësimit, pranë të cilës ai ka bërë regjistrimin në "Regjistrin për emigrantët", dokumentacionin e mëposhtëm:

a) për emigrantët të cilët do të largohen:

i) kopje origjinale të kontratës së punës të legalizuar, të nënshkruar nga palët (emigranti punëmarrës) ose kopje të noterizuar të saj; ose

ii) kopje të noterizuar dhe të legalizuar të dokumentit përkatës, që vërteton statusin e tij si i vetëpunësuar në vendin pritës;

iii) certifikatë personale me fotografi;

b) për familjarët, të cilët do t'i bashkohen emigrantit të larguar/që do të largohet për motive

punësimi:

i) certifikatë e gjendjes familjare në të cilën të provohet që ai është pjesëtar i familjes së emigrantit;

ii) kopje e noterizuar e autorizimit për ribashkim familjar nga vendi pritës;

c) për emigrantët e rikthyer:

i) kopje e pasaportës;

ii) deklaratë noteriale në të cilën shprehet vendimi i emigrantit për të punuar apo qëndruar mbi një vit në Republikën e Shqipërisë;

iii) certifikatë personale me fotografi;

iv) dokumentacioni përkatës, sipas statusit që ka pasur, që vërteton qëndrimin e tij/saj mbi një vit në vendin pritës.

5. Afati i vlefshmërisë së "Statusit të emigrantit" për emigrantët që do të largohen për motive punësimi, do të jetë në përputhje me kohëzgjatjen e kontratës së punës në vendin pritës, nëse nuk ndryshon statusin e tij të punësimit.

Për kategorinë e të vetëpunësuarve dhe të punëdhënësve, do të jetë në përputhje me afatin e përcaktuar në dokumentacionin e regjistrimit të tij pranë organeve fiskale të vendit pritës.

6. Afati i vlefshmërisë së "Statusit të emigrantit", për familjarët të cilët do t'i bashkohen emigrantit të larguar/që do të largohet për motive punësimi, do të jetë në përputhje me afatin e autorizimit për ribashkim familjar nga vendi pritës.

7. Afati i vlefshmërisë së "Statusit të emigrantit", për emigrantët e rikthyer do të jetë për një periudhë njëvjeçare.

8. Rinovimi i dokumentit "Statusi i emigrantit", kërkohet nga subjekti përfitues 30 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së tij. Kërkesa për rinovim shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri, për kategorinë të cilës i përket emigranti.

Familjarët, të cilët i janë bashkuar emigrantit të larguar, në kërkesën për rinovim të statusit mund të paraqesin edhe lejen e qëndrimit për ribashkim familjar, në rast se janë pajisur me të nga autoritetet e vendit pritës.

9. Zyra përkatëse e punësimit, pasi verifikon nëse dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri është i plotë, plotëson dokumentin "Statusi i emigrantit", i cili firmoset nga drejtori i saj.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale
dhe Shanseve të Barabarta
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

DOKUMENTI "STATUSI I EMIGRANTIT"

Për përfituesit e
Statusit të Emigrantit

Ky status është i vlefshëm me dokument identifikimi nga dt.___/___/___, deri në dt.___/___/___.

Lëshuar në _____

Emër _____

Mbiemër _____

Atësia _____

Datëlindja _____

Statusi i punësimit i emigrantit _____

Statusi i pjesëtarit të familjes _____

Drejtori

Zyra Rajonale e Punësimit

_____

VENDIM
Nr.1874, datë 28.9.2007

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR DEPUTET NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, NË ZONËN ZGJEDHORE NR.31, TË DATËS 23.9.2007

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij, të datës 28.9.2007, me pjesëmarrjen e:

Çlirim	Gjata	Kryetar
Flamur	Çato	Zv/Kryetar
Arben	Ristani	Anëtar
Dodë	Prenga	Anëtar
Fatmir	Kumbaro	Anëtar
Genti	Shala	Anëtar

Klement Zguri Anëtar
Shkëlqim Hysi Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në zonën zgjedhore nr.31, të datës 23.9.2007.

BAZË LIGJORE: Neni 2, pika 34, germa "a", neni 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve

VËREN:

Në datë 23.9.2007, në zonën zgjedhore nr.31, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave nga grupet e numërimit, KZZ-ja nr.31 miratoi tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe me vendim shpalli fitues z.Edi Tonin Paloka. Kundër vendimit të KZZ-së nr.31 brenda afatit ligjor nuk pati në KQZ asnjë ankim zgjedhor nga asnjë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme për deputet në zonën zgjedhore nr.31, të datës 23.9.2007.

Në referim të përcaktimeve të nenit 29 dhe nenit 2, pika 34, germa "a" të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 2, pika 34, germa "a", nenin 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

Të shpallë rezultatin e zgjedhjeve për deputet në Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore nr.31, të datës 23.9.2007, duke shpallur fitues z.Edi Tonin Paloka, kandidat i mbështetur nga Partia Demokratike.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.706, datë 2.7.2007, shpall të vdekur shtetasin Hamit Adem Sinani, i datëlindjes 10.1.1900, me datë vdekjeje 1.1.1965.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 1.10.2007
Doli nga shtypi më 3.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë